

IKSHPK- PARAROJË E SHËNDETIT TË POPULLATËS



Naser Ramadani

Specialist i Epidemiologjisë

Më 5 qershor 2025 Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës shënoi 100 vjetorin e ditës që shënon filltet e veprimtarisë së shëndetësisë publike në Kosovë. Ky jubile shënoi ditën kur në kuadër të adresimit të problemeve shëndetësore dhe të përkujdesjes amerikane ndaj popullatës së këtij rajoni të Evropës, Fondacioni i shquar humanitar nga SHBA "Rockefeller" e mbështeti themelimin për herë të parë të Shërbimit Higjieniko-Epidemiologjik edhe në Pejë. Ky shërbim do të fillojë punën më 5 qershor të vitit 1925 dhe kjo datë konsiderohet se shënon filltet e veprimtarisë së mjekësisë preventive në Kosovë, prandaj edhe shënohet si ditë e themelimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës.

Pa dyshim, të gjithë e kemi më të freskët njërën nga sfidat më të mëdha me të cilën u përballëm në vitet e fundit - pandeminë e COVID-19. Kjo pandemi, si kurrë më parë, e vuri në sprovë qëndrueshmërinë dhe aftësitë tona profesionale shkencore e humane, në përshtatjen e strategjisë tonë që ta mbrojmë shëndetin e popullatës. Ne i mobilizuam të gjitha forcat profesionale dhe shkencore për përballje të suksesshme me pandeminë COVID-19, duke qenë përherë në funksion të mbrojtjes dhe përmirësimit të shëndetit të popullatës.

Sfidat e kaluara kanë shërbyer në vazhdimësi për fokusimin edhe më të madh në ngritjen dhe forcimin e të gjitha kapaciteteve për të mbrojtur dhe avancuar më tej shëndetin publik. Në historikun e zhvillimit të veprimtarisë së shëndetit publik në Kosovë janë kaluar periudha të betejave të ndryshme të përballjes me kërcënime dhe rreziqe të kohës.

Fatkeqësisht, në dekadën e fundit të shekullit XX, Kosova do të përjetojë rrënimin e sistemit shëndetësor, që do të kulmojë me shkatërrimin e rëndë gjatë periudhës së luftës së fundit të viteve 1998/1999.

Periudha e pasluftës në Kosovë do të shënojë riorganizimin e sektorit të shëndetësisë publike, në një proces të reformave që do të përcillen me arritjen e rezultateve të çmuara në fushën e shëndetësisë publike në vendin tonë. Për gjithë këto vite, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike si institucion i lartë shëndetësor, profesional dhe shkencor i Kosovës me veprimtarinë e vet ka zbatuar me sukses strategjinë e shëndetësisë publike.

Në vazhden e rezultateve të shënuara në shëndetësinë publike janë shënuar suksese në luftimin e çrënjësjes së shumë sëmundjeve infektive, me zbatimin e Programit të Zgjeruar të Imunizimit me suksese evidente në luftimin e shumë sëmundjeve infektive vaksinë-preventabile. IKSHPK është angazhuar në përpjekje të vazhdueshme në luftimin dhe parandalimin e sëmundjeve kronike jo-ngjitëse përmes kontrollit të faktorëve të riskut dhe aktiviteteve të promovimit dhe edukimit

shëndetësor për të gjithë qytetarët, si dhe në kontrollin dhe monitorimin e shëndetit mjedisor, kualitetit të ujit dhe ushqimit, bazuar në udhëzime administrative sipas direktivave europiane.

IKSHPK ka realizuar, një varg projektsh shkencore dhe ka një bashkëpunim të gjerë dhe të afërt me institucione ndërkombëtare në fushën e shëndetit publik. Në veprimtarinë e vet IKSHPK kujdeset për implementimin e të gjitha rekomandimeve të OBSH dhe ECDC në lëminë e shëndetësisë publike. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës me veprimtarinë e vet mund të konsiderohet pa modesti si një pikë e ndritshme e shëndetësisë kosovare. Sfidat e shëndetësisë publike, me të cilat ballafaqohet Republika e Kosovës, mund të shqyrtohen nëpërmjet analizës së:

Qasjes epidemiologjike ndaj vlerësimit të nevojave shëndetësore; Statusit shëndetësor të grupeve të ndryshme të popullatës, Ambientit të jetesës dhe të punës, dhe Aspektëve organizative dhe strukturore të shëndetësisë publike

Problemet e botës janë me të vërtetë probleme botërore: krizat sociale dhe mjedisore, tregtia dhe politika globale dhe epidemitë e mëdha po e bëjnë shëndetin publik një shqetësim urgjent global.

Gjatë dy dekadave të fundit, diplomacia globale e shëndetit, politika e jashtme për shëndetin dhe politika globale shëndetësore kanë ndryshuar në mënyrë thelbësore. Diplomacia është pjesë përbërëse e sistemit të qeverisjes globale shëndetësore. COVID-19 goditi botën kur bashkëpunimi shumëpalësh ishte subjekt i sfidave të mëdha, dhe shëndeti global që atëherë është bërë pjesë përbërëse gjeopolitike. Ne aplikojmë një perspektivë të marrëdhënieve ndërkombëtare që reflekton mbi efektin në shëndet në vazhden e globalizimit. Bota ka ndryshuar në një dimension të pa parashikuar që na influencon në ndryshimin e konceptit themelor të shëndetësisë publike dhe adaptimin multidimensional, pasi diplomacia shëndetësore është shfaqur si një komponent kritik i marrëdhënieve ndërkombëtare, veçanërisht në kontekstin e globalizimit dhe rritjes së ndërvarësisë ndërmjet kombeve dhe implikimit e politizimit të diplomacisë globale shëndetësore në një botë të multipolarizuar.

Duke pasur parasysh të gjitha të arriturat, sukseset e në veçanti sfidat e mëtejme që kemi përpara, edhe në këtë ditë solemne duhet theksuar se Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës do të vazhdojë të jetë i përkushtuar në angazhimin e vet në mbrojtjen dhe përmirësimin e shëndetit të popullatës, bashkë me të gjitha institucionet e vendit, për të përmbushur vizionin për një popullatë të shëndoshë, në mjedisin e shëndoshë, në një shtet të shëndoshë.